



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Prill 2021

Nr: 235

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Librazhd

**Kërkues:** Z. Bujar Vreto, Kryetar i Partisë Demokratike, Dega Librazhd

**Ndaj:** Z. Kastriot Gurra, Kryetari i Bashkisë Librazhd

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, 78 pika 6, 79, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ,



Data: 14 Prill 2021  
Nr. 235

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator dhe udhëzimi nr. 6/2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

## VËREN:

### I.

#### Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 209/1 prot. datë 05.04.2021, administruar me shkresën nr. 3297 prot. datë 07.04.2021, është paraqitur një kallëzim nga Kryetari i Partisë Demokratike, Dega Librazhd, për afishim të materialeve propagandistike në fasadën kryesore të godinës së Bashkisë Librazhd, në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Në këtë kallëzim pretendohet se: *“Në datën 05.03.2021, kemi konstatuar se në fasadën kryesore të godinës së Bashkisë Librazhd është afishuar një material propagandistik “poster”, me përmbajtje “VOTO 12 PS”; Shqipëria e ardhmja jonë; #skakohëpërpushim”. Sipas përcaktimeve të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ndalon shprehimisht përdorimin e burimeve shtetërore për mbështetjen e kandidatëve, partive politike, koalicioneve zgjedhore... Në këto kushte, është e qartë se afishimi i një posteri elektorale të Partisë Socialiste në fasadën kryesore të Bashkisë Librazhd, është në kundërshtim të hapur me nenin 91, të Kodit Zgjedhor, nenet 3 dhe 7 të vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ndalojnë rreptësisht afishimin e materialeve propagandistike në fasadat e institucioneve. Kërkojmë urdhërimin e menjëhershëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për heqjen e posterit elektorale të Partisë Socialiste nga fasada e Bashkisë Librazhd dhe dënimin e Kryetarit të Bashkisë Librazhd dhe zyrtarëve të tjerë përgjegjës për mosmarrjen e masave për respektimin e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore.”*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’ a një shprehimisht Rregullatorin apo Kas-it.



Referuar nenit 7 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, Dega Librazhd përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II.

### Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit”, duke filluar nga kjo datë.

Referuar nenit 3, pika 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “c”, konsideron veprimtari të ndaluar “ *vënia në dispozicion e asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit*”.

Z. Bujar Vreto, Kryetari i Partisë Demokratike, Dega Librazhd nëpërmjet shkresës nr. 209/1 prot. datë 05.04.2021, administruar pranë KQZ me shkresën nr. 3297 prot. datë 07.04.2021, ka dërguar një kallëzim ku pretendohet se “ *Në datën 05.03.2021, kemi konstatuar se në fasandën kryesore të godinës së Bashkisë*



*Librazhd është afishuar një material propagandistik “poster”, me përmbajtje ‘VOTO 12 PS’; Shqipëria e ardhmja jonë;#skakohëpërpushim”. Neni 91 i Kodit Zgjedhor ndalon shprehimisht përdorimin e burimeve shtetërore për mbështetjen e kandidatëve, partive politike, koalicioneve zgjedhore. ...Në këto kushte, është e qartë se afishimi i një posterit elektorale i Partisë Socialiste në fasadën kryesore të Bashkisë Librazhd është në kundërshtim të hapur me nenin 91, të Kodit Zgjedhor; nenet 3 dhe 7 të vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ndalojnë rreptësisht afishimin e materialve propagandistike në fasadat e institucioneve. Kërkojmë urdhërimin e menjëhershëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për heqjen e posterit elektorale të Partisë Socialiste nga fasada e Bashkisë Librazhd dhe dënimin e Kryetarit të Bashkisë Librazhd dhe zyrtarëve të tjerë përgjegjës për mosmarrjen e masave për respektimin e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore.”*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi nëse në fasadën kryesore të godinës së Bashkisë Librazhd, është afishuar material propagandistik në favor të Partisë Socialiste, në kundërshtim me rregullat e vendosura në nenin 3, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka konstatuar shkelje nga Bashkia Librazhd, sipas parashikimeve të nenit 3 i udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

### III

#### **Analiza juridike dhe konkluzione**

Referuar nenit 3, pika 2, i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcaktohet rrethi i subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

*“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.*

Referuar nenit 3, të udhëzimit nr. 6 datë 23 mars 2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, parashikohet se, “Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambientet rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit”.

Referuar pikës 1, të nenit 79 të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë, përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2564 prot., datë 24.03.2021, i është drejtuar Bashkive për përmbushjen e detyrimit sipas parashikimeve të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me shkresën nr. 1593 prot., datë 18.09.2021, Bashkia Librazhd ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendimin e datës 18.03.2021 “Për përcaktimin e vendeve

publike në territorin e Bashkisë Librazhd për afishimin e materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore”.

Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se, “Ndalohet afishimi i materialeve në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambjenteteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndricimit”.

Sipas denoncimit të mësipërm, vendosja e materialeve propagandistike është bërë në pjesën ballore të godinës së Bashkisë Librazhd, fakt që rezultoi i provuar nga fotografitë e dërguara nga personat e autorizuar nga KQZ për Bashkinë Librazhd.

Bazuar në nenin 3, pika 2, i vendimit nr. 9/2020, Kryetari i Bashkisë si subjekti përgjegjës për zbatimin e vendimit, nuk ka përmbushur detyrimet sipas parashikimeve të nenit 78 pika 6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 3, pika 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “c” e vendimit nr. 9/2020.

Referuar nenit 78, pika 6, e të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, “*Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike*”.

Sipas përcaktimeve të nenit 3, të udhëzimit nr. 6 datë 23 mars 2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, “*Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambjentet rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit*”.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenin 3, të udhëzimit nr. 6/2021, të sipërcituar, konstaton se mosmarrja e masave për heqjen e materialit propagandistik nga fasada e Bashkisë Librazhd, ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Librazhd.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, 78 pika 6, 79, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:



## V E N D O S:

1. Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa të menjëhershme për të hequr materialin propogandistik nga fasada e godinës së Bashkisë Librazhd.
2. Kryetari i Bashkisë Librazhd, të njoftojë menjëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**



Data: 14 Prill 2021  
Nr. 235

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator dhe udhëzimi nr. 6/2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve